

**RAPORTI I RI:**

**‘TERMOCENTRALET ME QYMYR NË BALLKANIN  
PERËNDIMOR PO SHKELIN RËNDË LIMITET E  
NDOTJES SË AJRIT’**

Vendet e Ballkanit Perëndimor i tejkalojnë rreth 6 herë më shumë limitet e ndotjes së ajrit të dakorduara me Komunitetin e Energjisë sa i përket emetimeve të SO<sub>2</sub>, thuhet në raportin e publikuar nga CEE Bankwatch Network dhe mbështetur nga Instituti INDEP.

Lexoni raportin e ri të Bankwatch: <https://bankwatch.org/publication/comply-or-close-how-western-balkan-coal-plants-breach-air-pollution-laws-and-what-governments-must-do-about-it>

Sipas hulumtimit, emetimet totale të SO<sub>2</sub> nga termocentralet e qymyrit në Serbi, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoninë e Veriut ishin më se gjashtë herë më të larta në 2018 sesa limiti i përgjithshëm i rënë dakord me Komunitetin e Energjisë bazuar në Planet Kombëtare për Zvogëlimin e Emisioneve.

Emetimet e pluhurit nga termocentralet e qymyrit në Serbi, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe në Maqedoninë e Veriut gjithashtu kanë tejkaluar limitet me mbi 60 përqind. Vetëm kontributet e Serbisë dhe të Kosovës ishin të mjaftueshme për të shkelur madje limitin e përgjithshëm.

Kosova B ishte termocentrali me emetimet më të mëdha të pluhurit në të gjithë rajonin, duke prodhuar rreth gjysmën e totalit të lejuar për të katër vendet bashkë.

Vendet në Ballkanin Perëndimor janë nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, i cili përfshinë caqet për uljen e ndotjes industriale, i pari prej të cilëve duhej të ishte zbatuar deri në vitin 2018. Megjithatë, hulumtimi i ri thekson se, jo vetëm që vendet po i shkelin angazhimet e tyre, por në disa termocentralet në rajon, nivelet e ndotjes janë përkeqësuar.

"Duke pasur parasysh natyrën kërcënuese për jetë të ndotjes së ajrit, neglizhimi i kësaj çështje nga qeveritë e rajonit është i pakuptueshëm dhe i dënueshëm. Investimi në kontrollim të ndotjes nuk është thjesht një detyrim ligjor, por është gjithashtu detyrë e çdo qeverie që kujdeset për njerëzit e saj," tha Ioana Ciuta, Koordinatorë për çështje të energjisë në Bankwatch dhe njëra nga autorët e raportit.

"Dy termocentralet vazhdojnë të jenë burime alarmante të ndotjes në vend. Sipas strategjisë aktuale të energjisë në Kosovë, mbyllja e termocentralit Kosova A parashihet të ndodhë në momentin kur të vihet në funksion Kosova e Re. Mirëpo, duke qenë që zhvillimet për sa i përket projektit Kosova e Re kanë ngecur, nuk mund të justifikohet mungesa e veprimit të Qeverisë në drejtim të rehabilitimit ose në rastin më të mirë, mbylljes së tij. Qeveria e re duhet të fokusohet në përpilimin e skenareve alternative për prodhimin e energjisë në vend. Këto vendime duhet të merren tani dhe duhet të jenë prioritet i qeverisë së ardhshme." – thotë Learta Hollaj nga INDEP.

Raporti përfshinë rekomandime se si qeveritë e katër shteteve mund të përmirësojnë monitorimin dhe kontrollimin e ndotjes, si dhe për mënyrën se si Bashkimi Evropian duhet të veprojë për të fuqizuar Komunitetin e Energjisë, si dhe për të siguruar që shkeljet e limiteve të ndotjes të mos vazhdojnë pa u ndëshkuar.

Shënim:

1. Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk e ka dorëzuar raportin e emetimeve për vitin 2018 në Agjencinë Evropiane të Mjedisit, edhe pse ishte e detyruar ta bëjë këtë. Prandaj, duke pasur parasysh që asnjë investim i madh nuk është realizuar ndërmjet viteve 2017 dhe 2018 në kontrollimin e ndotjes, në raport janë marrë për bazë shifrat e vitit 2017.

**Për më shumë informacion, kontaktoni:**

Leartha Hollaj  
INDEP  
E-mail: [leartha.hollaj@indep.info](mailto:leartha.hollaj@indep.info)  
Mob.: +38349499944

Ioana Ciuta  
CEE Bankwatch Network  
E-mail: [ioana.ciuta@bankwatch.org](mailto:ioana.ciuta@bankwatch.org)  
Mob.: +40724020281

Pippa Gallop  
CEE Bankwatch Network  
E-mail: [pippa.gallop@bankwatch.org](mailto:pippa.gallop@bankwatch.org)  
Mob: +385 (0)99 755 9787